

VENDIM
Nr. 737, datë 3.12.2021

PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE, NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, PËR KONTRATËN E KREDISË NDËRMJET INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SHA, PËR FINANCIMIN E KAPITALIT QARKULLUES NË KUADËR TË NEVOJAVE PËR IMPORT TË ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., për financimin e kapitalit qarkullues në kuadër të nevojave për import të energjisë, në shumën 20 000 000 (njëzet milionë) euro.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE Group sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj